

E PERJAVSHME LETRARE-ARTISTIKE-ORGAN I LIDHJES SE SHKRIMTAREVE DHE TE ARTISTEVE TE SHQIPERISE

Të ngremë nivelin ideoartistik të dramaturgjisë

Dramaturgjia është buka e teatrove. Pa dramaturgjia nuk ka repertor dhe pa këtë teatri humb rolin e tij si edukator patriotik, revolucionar dhe estetik i masave.

Dramaturgjia jonë e realizmit socialist ka krijuar tanimë një traditë të pasur, e cila ka shërbyer e shërben për edukimin komunist të masave punonjëse. Teatri ynë i ka shfrytëzuar më së miri veprat tona dramaturgjike, ka vënë e rivënë në skenë ato, duke nxjerrë në pah idetë e fuqishme të tyre. Veprat më dinjitoze kanë hyrë në repertorin aktiv të teatrit dhe janë bërë të njohura e të dashura për mijëra spektatorë. Edhe këto dy vjetët e fundit janë shkruar vepra të mira. Mirëpo ndjehet e nevojshme që dramaturgjia jo vetëm të pasurohet me vepra të reja, por ato të kenë edhe një nivel ideoartistik të lartë.

«Është e domosdoshme, - tha shoku Enver në fjalën e 20 dhjetorit 1974 - që dramaturgjia jonë të ngrihet në një nivel sa më të përsosur, t'u largohet banaliteteve, dhe jo vetëm t'i përgjigjet shkallës së shtetë të kulturës së masave që frekuentojnë këtë teatër, por ky të jetë njëkohësisht frymëzues i një përparimi të mëtejshëm të shijeve dhe të hovit revolucionar për një jetë më të kulturuar».

Partia vazhdimisht ka orientuar se si duhen frymëzuar krijuesit dhe organizuar puna që të shkruhen sa më shumë vepra me nivel të lartë ideoartistik. Veçanërisht këto dy vjetët e fundit, dmth pas plenumit IV të KQ të PPSH, Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve, teatrot e spektatorët i ka preokupuar vazhdimisht problemi i mbarëvajtjes dhe i përparimit të dramaturgjisë.

Vetë krijuesit në diskutime të gjera e në mbledhje të Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve apo të Komitetit të Kulturës e të Arteve kanë rrahur problemën e ngritjes së mëtejshme të nivelit ideoartistik të dramaturgjisë. Ata kanë shprehur mendime konkrete se si mund të ecë përpara dramaturgjia me një rritje më të shpejtë, që t'u përgjigjet sa më mirë nevojave të teatrove profesioniste dhe amatore,

që të kënaqë sa më mirë kërkesat ideoestetike të masave punonjëse.

Të gjitha këto si dhe veprimtaria krijuese e dramaturgëve kanë bërë që të kapërcehen në një masë të mirë mungesat që u panë në repertorin e vitit 1972-1973, kur më tepër viheshin në skenë drama të njohura, kurse të reja fare pak.

Po kështu, në përgjithësi, u mënjantuan veprat ku dukeshin ndikimet e artit dekadent borgjezo-revizionist dhe u kritikuan si antisocialiste, që shtrëmbëronin vijën politike të Partisë me qëllime të caktuara pseudodramat e armikut të popullit e të Partisë F. Paçrami.

Dramaturgë e shkrimtarë, duke ndjekur mësimet e Partisë, me një punë serioze e këmbëngulëse u aktivizuan gjerësisht për të nxjerrë dramaturgjinë nga ajo lloj prapambetje që vihej re në krahasim me gjinitë e tjera. Në konkursin e 30-vjetorit të çlirimit të Atdheut morën pjesë dhjetëra autorë të njohur e të rinj. Pati disa edhe nga ata që debutonin për herë të parë në këtë gjini.

Nga dramati që u paraqitën në konkurs deri tani teatrot kanë vënë në skenë 25 prej tyre. Nga këto mund të përmendim «Zonja nga qyteti» e R. Pulahës dhe «Me gjuthën e pushkës» e H. Minarollit, vënë në skenë nga trupa e teatrit të Korçës, «Shpartallimi» e F. Krajës, vënë në skenë nga teatri i Shkodrës, «Lumi i vdekur» e K. Velçës dhe «Duke u gdhirë viti '45» e T. Laços, vënë në skenë nga Teatri Popullor etj.

Në këto drama ndjehet herika e luftës dhe e punës, besimi në fitoret e revolucionit dhe socializmit, optimizmi për ditë të lumtura etj. Për t'u shënuar është se heroit pozitiv i është kushtuar një vëmendje e madhe nga autorët dhe kjo jo rastësisht. Ndikimet dhe kjo jo teorizimet që u vërejnë e huaja dhe teorizimet IV të KQ të PPSH goditën pikërisht heroin pozitiv në dramë dhe rrufjanët politikë kërkonin një hero modernist që të tallej me idealët tonë të shenjtë. Prandaj dramaturgët tanë të partisëm, në vazhdim të traditave tona më të mira, në këto dy vjet kanë punuar që heroi pozitiv të zërë vend qendror në vepra dhe të dalë sa më i plotë. Pra, sezoni teatral që kaloi

shënoi disa suksese, të cilat duhet të shërbejnë edhe si përvojë për të çuar më përpara dramaturgjinë. Kjo përvojë duhet të vlejë edhe për dramaturgët, edhe për teatrot, pasi autori dhe teatri janë si mishi me kockën e nuk bëjnë dot pa njëri-tjetrin. Atje ku ka bashkëpunuar mirë teatri me autorin ka patur suksese, ku nuk ka ditur të punojë suksesi kanë qenë të pakta. Teatri i Korçës, Shkodrës, Elbasanit, kanë bashkëpunuar mirë me autorët, kurse Teatri Popullor dhe ai i Vlorës kanë patur dobësi, megjithë punën e mirë që kanë bërë. Këto të fundit nuk i kanë mirëpritur disa vepra.

Krahas këtyre, nga përvoja e dramaturgjisë së kohëve të fundit, dalin disa probleme të rëndësishme, të cilat janë plotësisht të zgjidhshme.

Tanimë drama doli nga një lloj shterpësie që vihej re. Ajo ka sasi. Drama janë shkruar mjaft dhe një pjesë e tyre janë vënë në skenë. Problem aktual është rritja e nivelit ideoartistik. Në disa prej tyre ka patur dhe recidive të ndikimeve të huaja. Kjo ka ardhur nga mungesa e pjekurisë ideologjike, nga thëllimi i pamjaftueshmëri në orientimet e Partisë, nga përvetësimi i dobët i estetikës marksiste-leniniste. Deomos këto recidive kanë qenë të pakta. Më të theksuara janë të metat në mjeshtërinë artistike. Në drama ka një cektësi mendimi e zbehtësi konfliktit. Kontradiktat nuk zbulohen e zgjidhen gjithmonë drejt e në gjerësinë e tyre dhe shpesh u kalohet anash. Prandaj edhe karakteret dalin të dobët. Prej këtej vjen edhe mungesa e mendimeve të mëdha; personazhet flasin me gjuhë vulgare e pampoze. Vakumi i mendimeve mbushet me fraza të fryra. Heroi poshet me fraza të fryra. Heroi pozitiv i dramës «Lumi i vdekur», zitiv i dramës «Lumi i vdekur», p.sh., shpesh është një frazist. Një fshatar si ai, para formimit të Partisë, nuk mund të bëjë agjitacion mes argatëve se na duhet një Parti si e Leninit në Rusi. Nuk është bindës, aq më tepër kur ky konkluzion vjen papritur, pa një përgatitje të situatës dramatike. Heronjtë pozitivë tek drama «Me gjuthën e pushkës», me gjithë konfliktin e gjetur mirë, në mjaft

(vijen në f. 2)

«Kur flet klasa, nuk flet buro- kratizmi»

I avën e kaluar, në Partinë e Kulturës në Tiranë, Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë organizoi hapjen e ekspozitës së karikaturës me temë «Kur flet klasa, nuk flet burokratizmi».

Morën pjesë punonjës të qendrave të punës, të rinj e të rejal artdashës, piktorë, karikaturistë e punonjës të tjerë të artit e të kulturës të kryeqytetit, si dhe të ftuar të tjerë.

Në të janë paraqitur 33 punime në karikaturë me anë të të cilave piktorët Zef Bumçi, Bardhy Fico, Dhimitër Ligori, Shtjefën Palushi e të tjerë, duke u frymëzuar nga jeta në vendin tonë, trajtojnë aspekte të luftës së klasave punëtores, nën udhëheqjen e Partisë kundër shfaqjeve të burokratizmit.

(ATSH)

«Mbrotja e Atdheut - detyrë mbi detyrat»

Klubi i rinisë «Heronjtë Vigut» të qytetit të Shkodrës po organizon herëpashere aktivitetet kulturore - artistike. Në vazhdim të këtyre aktiviteteve është edhe mbledhja tematike «Mbrotja e Atdheut - detyrë mbi të gjitha detyrat».

Gjithashtu është hapur ekspozita e talenteve të reja në pikturë «Tema e ushtrisë në artet figurative». Edhe trupa e estradës amatore e klubit të rinisë dha në fshatin Tale të Lezhës, para ushtarëve dhe rezervistëve, një program të pasur artistik.

Njëkohësisht klubi i rinisë po u jep ndihmë të mirë grupeve artistike amatore. Kohët e fundit ai ndihmoi stacionin e zooteknikës, ndërmarrjen e grumbullimit, NP artistike për gjallërimin e mëtejshëm të jetës kulturore-artistike, për të dalë sa më me dinjitet në festivalin e estradave amatore që u zhvillua në ditët e para të gushtit.

Korresp. i «Dritës»

(vijon nga f. 1)

raسته nuk kanë mendime të thella. Ata shpesh thërërasin më frata të karakterit shabllon e skematik. Kjo vijon edhe nga që konfliktet janë të dobët në dramë, janë bardhë e zi. Autorët nuk hyjnë si duhet në botën shpirtërore të personazheve, i nxjerrin ata pa kockë, pa karakter e individualitet. Në shumë raste nuk janë njerëz realë të një kohe të caktuar e që veprojnë në një situatë konkrete, por janë njerëz të trilluar, njerëz në përgjithësi, pa vend e pa adresë kohe.

Një problem tjetër është edhe ai i lhyerjes së nivelimit që krijon sot në dramaturgji. Është fjalë për krijimin e dramave me tema të rëndësishme nga kyçet e historisë së luftës dhe të viteve të ndërlimit socialist të vendit, ashtu siç kemi disa poema dhe romane që mbelen si kulme të artit

tonë. Të kuptohemi, fjala është për vepra të tjera të nivelit të dramave «Toka jonë», «Familja e peshkatarit», «Cuca e maleve» etj, që t'i rezistojnë kohës e të mbeten në repertorin aktiv të teatrove tona.

Mirëpo drama të nivelit të lartë ideartistik nuk mund të bëhen në se autorët nuk futen dhe nuk kuptojnë thellë epitetin dhe dramaticitetin e kohës sonë, të luftës së madhe që bën Shqipëria nën udhëheqjen e Partisë në këtë botë të mbërthyer në darën e kundërdiktave të mëdha. Çdo krijues duhet të kuptojë madheshinë e luftës e të punës që bën populli, për të ndërtuar socializmin edhe mes armiqve të tërbuar, edhe në kushtet e rrethimit të egër borgjezo-revizionist, se kemi në ballë Partinë, se kemi një popull patriot, revolucionar e krenar. Prandaj, duke kuptuar thellë këtë thelb, edhe dramaturgët do të

pasurojnë tematikën, do të zgjerojnë horizontin e ideve dhe të mënyrave të të shkruarit dhe të zgjidhurit të problemeve në dramë.

Është e domosdoshme që për të parashtruar ide të mëdha të vibet në qendër të dramave figura e komunistit ai që është thirrur në jetë nga historia për të shndërruar botën, shoqërinë e njeriut. Vetëm dramat me tema të mëdha e nivel të lartë ideartistik zgjidhen tek spektatori emocione të llogjshme. Veprat e kësaj natyre do të bëhen pastaj një bazament i fortë për t'u ngritur edhe të tjerat dhe anasjelltas. Këto duhet të jenë edhe synimet e çdo dramaturgu.

Për të aritur sa më mirë këtë, që edhe në dramaturgji të bëhet një hop cilësor, do të ndihmojë edhe atmosfera e shëndoshë e partishme dhe shoqërore që ekziston midis shkrimtarëve dhe artistëve

tanë. Të dhënat janë optimiste në çdo drejtim. Sasia e dramave dhe niveli artistik i gjertanishëm do të ngrenë me siguri edhe cilësinë. Për këtë është e domosdoshme të preokupohen për dramaturgjinë dhe shkrimtarët tanë më të njohur, pasi përvoja e tyre artistike është e madhe dhe kjo do t'i shërbejë të gjithëve.

Përvoja e fituar duhet të shërbejë si bazë për suksese të reja të dramaturgjisë dhe teatrit tonë, i cili ndodhet para sezonit të ri të këtij viti. Vetëm duke u thelluar në detyrat e plenumit IV të KQ të PPSH dhe mësimet e shokut Enver, vecanërisht ato për teatrin që dha në fjalën e 20 dhjetorit, duke njohur problemet e jetën e popullit, kërkesat e tij estetike, dramaturgët do të jenë në gjendje të japin edhe në të ardhshmen vepra të reja dinjitoze, të cilat do të hyjnë në fondin e dramaturgjisë sonë të realizmit socialist.